



Agim
Spahiu

Vjen
një
moshë



poezi



8JH-1
581.

Agim
Spahiu

Vjen
një
moshë



14638

poezi

Urat e Kukësit

Të zakonshme brigje nuk lidhin,
po zemrat e maleve të larta;
gjigantet ura dhe qiellin
me madhështinë kanë ndarë.

Përmes krahëve të betontë
vijnë qytetet e atdheut tim
dhe qyteti i ri shqiponjë
niset në gjithë Shqipërinë.

Mesnata në qytezën minatore

Tani që ka kaluar mesnata
flenë njerëzit e punës me orë fikse,
në qytetet e bardha të maleve
radhazi dritat ndizen e fiiken.

Pallatet me dritare nga miniera
e kanë me radhë ndriçimin —
kjo do të thotë se ata që punuan erdhën,
të tjerë që do të punojnë nisen.

Minatorët janë zemra e qytezave
dhe zemra e minatorëve — të minerali.
Zgjimi këtu është i përjetshëm
e madhështor sa dhe mali..

Likeni i kuq¹

S'ka asnje liqen
toponomastikën e çuditshme
të krijonte.

Në jetë të jetës
luftëra dhe derte
me ngjyrën e gjakut
emëruan fshatin...

1) Fshat në Has.

Qyteti i dritës

Hap dritaren e vogël,
Kukësi i Ri –
karafil i bardhë shpaloset.

Trak, çelësin e dritës,
Kukësi i vjetër –
karafil i kuq ndizet...

Largimi i brrutasve për në Krumë

I pashë brrutasit¹⁾...

I pashë brrutasit
të fitonin urtësinë e klasës,
forcën e saj,
kur po ndaheshin prej pronës private.
S'ishte thjesht largim.
As ndarje
e dhembshme malli e brenge
me tokën.
Drita të fuqishme në ndërgjegje
po ndezin
nga hidrocentrali gjigant i kohës.

1) Banorë të fshatit Brrut

Morën me vete
çdo gjë që u duhej
dhe u larguan.
Si shenjë jetë
e mikpritjeje
për udhëtarë
kovë dhe litar
pranë pusit
lanë brrutasit...

Dritë pune

Po bie shi në qytezën bujqësore,
fusha e lagur shtrihet;
diku ende një peshore
sikur mat qiellin e rëndë e të hirtë.

I lagur kthej nga shkolla,
baltën udhës ngjesh me çizme;
transistori emrin tënd, vëlla,
ma solli mes fushës në shi.

Ti nxjerr patate në Topojan
dhe motra po këtë punë bën në Shishtavec,
prindërit me merakun e shpërndarë
kanë mbetur me të voglin në qytet.

Dritë punë çdo ditë kërkon kjo kohë
dhe gjer në palcë ndershëmërinë,
ndaj emri yt i dashur më gëzoi
që u përmend për punë të mirë.

SHALLOVË

Shallovë

Shallovë, shallovë, shallovë, shallovë,

Fusha pas mbjelljes

Fusha pas mbjelljes çuditërisht e qetë shtrihet. E shkrifët, nanuritëse, pa zë, me mërmërimë të brendshme, të lehtë, farës i këndon një nina-nanë.

Dhe gjurmët që në fund të punës shkelën me aq kujdes tregojnë se do të vijnë bujqit e mirë pranë fushës së sapombjellë.

(As fara s'mbin pa nina-nanë...)

Vetëm ata kanë zotësinë të dinë:
në dheun e ngopur me diell,
farë të zgjedhur e dashuri, meraku
rri, si në rritjen e fëmijës
sytë e prindit rrinë...

Pragmbrëmja e së shtunës në fshatin e ri

Eshtë kaq e pastër kjo pragmbrëmje e së shtunës,
sa ke dëshirë ta prekësh me dorë,
ta ledhatosh butë-butë si njeriun që don fort.
Dhe përendimi i diellit të duket njerëzor
kur nga puna kthejnë punëtorët
me fitore të lodhshme e të frytshme.
(Edhe diellin e verës duket kanë ulur
në veglat e punës, mbi supe...)

Unë, i sapokthyer nga shkollë e largët,
pranë drithares ha drekë e darkë bashkë
(Ju qëllon ndonjëherë kështu?...)
Radioja jep një pjesë të dashur orkestrale

dhe gruaja ime ulur pranë meje,
thur triko për beben tonë të ardhshme
e gjithë merak në bebëz të syrit më shëh.

Ata kthyen nga fushat e verës,
urojnë dhe përshëndeten. Kjo pragmbrëmje e së
shtunës,
e prekshme, pa shtirje në sy u rri.

Dyert dhe dritaret, e dashur, hapi,
kaq nevojë kemi për himnin e jetës...

Natë shirjesh

Kjo është beteja:
uturima e małkinave shirëse,
automjete që hyjnë e dalin në lëmë,
thasë gri, të bardhë,
zetorë të ngarkuar, kashtë,
duaj në ajër,
kavaleta që zhduken,
gruri në thasë,
fytyra të dirsura,
të dashura, të afërtë,
duar punëtori, shoku,
urdhëra, zëra në kalim,
një darkë e vonët që hahet në këmbë,
projektorë të zjarrtë që terrin kanë ndezur

mes lëmit e qiellit, —
nata, e papushtetshme,
përgjunjur
para njeriut të punës...

B r e z a t

Në valle
e jetë
brezi
në brez,
si shekulli
në shekull,
mbështetet...

Opingat e Hasit

Gratë e luftëtarëve
me penj të pambuktë
thurnin opinga.

Dhembla
me duart e grave
në hapësirën e thurur
krijonte zemra, lule
e një dorë fëmije
me gishtërinj të butë
si sytha lajthie...

Kur malli kapte luftëtarët
qëndismat flisnin
si njerëz të afërt.

Zinin prita në gryka,
male dhe hone
dhe kur binin si lisa,
dorë e njomë
vinte
u freskonte ballin,
u fshinte gjakun,
si një përkëdhelje
zgjatej...

Dashuria e dhembja e grave
me ato penj të zakonshëm
gjelbëronin shpirtin e luftëtarëve
dhe stinët
befasonin...

Punëtorët e fushës

Miq e mysafirë kam ata
me vegla pune mbi supet pak të rëna,
harkuar si hëna,
me gjëzim të natyrshëm e lodhje
në fytyrat diellore...

Prek shqetësimin e njeriut,
që veten punës ia jep pak nga pak
dhe djersën ia fshin shpina e dorës, pa bujë.
Nga balli i gjerë, në çdo rrudhë
mendimet shfaqen të pastra, të mëdha
si në duart e tij rritet buka...

Fytyra e shokëve

Tre minatorë ndezën cigaret në një kohë
në lulen e zjarrtë të llambës me karbit
dhe bërrylat mbështetën një çast në vagon.
Fytyrat e dirsura në një u shkrinë –
e plotë, burrërore fytyra e shokëve,
diell i heroizmit të vërtetë...

Vjen një moshë

Vjen një moshë ngadalë, pa kuptuar,
të ve dorën miqësisht mbi shpatulla,
atëherë kujtohesh se diçka ke humbur
dhe për një çast të pushton keqardhja.

Pastaj qesh dhe shkon dorën në filokë,
pahun e bortë të shkundësh shpejt e shpejt,
atëherë kupton se ka ardhur kjo moshë
nga gjërat që ke krijuar në jetë...

Vrasja e korrierit partizan

Në mesditë,
mes zhegut rraskapitës
e hodhën.
Do të vdesësh, i thanë,
në orën më të vdekur.
Gjaku do të buisë trupit,
do të digjesh
për pikën e ujit
në minutën e fundit
dhe askush s'do ta dëgjojë lutjen...
...Ish ora më e vdekur e ditës
dhe zheg, zheg rraskapitës.
Trego pa frikë, i thanë,
s'të dëgjon njeri.
Në minuta e sekonda të tmerrshme

shpëto veten!
Gjallëron jeta:
bar i gjelbër jeton me rrënjen
në dhe
dhe reja shkon e vjen.

Ti, i bëkur dhe i freskët,
duhet ta jetosh jetën,
sepse që tani, në mesditë,
mes pluhurit të udhës,
zhegut rraskapitës
mund të përqafosh dheun.

Qeshi. I pështyu. Si bubullimë
e qeshura
ra mbi zhegun dhe qytetin, —
zgjoi orën më të vdekur të ditës
dhe yll' i tij prej yllësisë së lirisë
ndriti qytetin,
që u bë zemra e trimtit
dhe nderoi
burrërinë e guximin...

Një nënë këndon dëshmorët

Sa të bukur ma keni shtatin,
puthur-o me bajrakun,
veshur mermer të bardhë,
djem-o, djemtë e nënave.

Sa të bukur ma keni ballin,
ballin-o larë me drithë,
aty zemra nxori gjakun,
trim-a-o, trimat e nënave.

Sa të bukur ma keni jetën,
të kuqe-o me të gjelbër,
të gjithë rroni në këngët,
yje-o, yjtë e Atdheut.

Mos kujtoni se kemi harruar!

Mos kujtoni se kemi harruar!

(Oh, jo, ne nuk harrojmë lehtë,
bile asgjë nuk harrojmë në jetë...)
Shekujt e brezat na mësuan:
mos fal kurrë,
të jesh i rreptë!

Se mund të visheni me çdo rrrobë,
çdo gjuhë mund të flisni (edhe gjuhën tonë...)
Mund të qani si fëmijë zëlutës me gojë prej ujku,
mund të krijoni «art modern», «kryevepër»,

mund tē këndoni dhe «këngë moderne» gjithashtu.
mund tē shpikni lloj-lloj manevrash që tē
miqësoheni me ne

e në natën e parë tē miqësisë makbethiane
me thikën e dashurisë në shpatulla tē flemë...

Mos kujtoni se kemi harruar!

Gjakun e vëllezërve, etërve
tē ngrohtë kemi në duar,
si prush na djeg...
Borova, Përbregu, fshatra, qytete
përcëlluar e rrënuar
digjen brenda mesh, digjen...
Fëmijët mbi shkëlqim bajonetash
si mollë në majë tē thikës,
ende na tmerrojnë shpirtin.
Hekuri i skuqur e xhamat e copëtuar
në Mathauzen e Ventotene
në trupin e lirikërkuesve
t'i kemi harruar s'ka se si...

Në lëmenjtë me grurë mbajmë armët,
edhe në shtëpitë e lindjes tytat kemi ngrehur,
se gjithmonë bukën dhe fëmijën
të parët na i keni therur.
Fushat, malet, gjithë tokën
më shumë se me grurë
me vigjilencë popullore e kemi veshur...

I) Prologu

Një cipë borë
e hollë,
si shamia jote
mbi kokë,
nënë Leme,
ngriu dhenë
natën e 26 prillit.
... Kërkohej ngrohtësi
prej gjakut tonë,
bir,
të çelej e gjithë
pranverë e lirisë...

2) Lieber gott!

Armiqtë ecnin nëpër natë. Terr si nata
dhe ata. Armatosur për terror. Lieber Gott!¹⁾
Mërmërisnin nëpër dhëmbë. Gjarpëronin.
Në shpinë vdekjen mbartnin kafshët,
peshë e rëndë i përkulte. Dhe ushtarët
kuturu hidhnin këmbët nëpër borë.
I tmerroi ftohtësia, malet varg e varg
ballëmendar, supengjeshur-malësorë.
Lieber Gott! Lieber Gott!
Heshtje e zymtë dhe e lartë
vdekjen mundësonte në çdo hap.
Me acar e piskamë Qafë e Prushit a,s'i priti?

1) Lieber Gott! (gjerm.) — O zot i madh!

Mëngjes i hershëm, për ta veç një gropë.
(Lieber Gott!)

Dhe shtëpi e shënuar për terror
krisma e vetëtima nisi. Malet,
si përbindësha, mbi ta këmbët po i vinin.
Luftonin yjet me kryqin e thyer...

3) Shtëpia

Atje në thellësi malesh, në Vlahën,
shtrihet lugina gojë e hapur,
mbaron ku e përpjeta e mundimshme
sulet të kapë kokën e malit.

Dhe kur s'arrin të kapë kokën në re,
diku në mes e nxjerr kokën e vet, —
aty ngrihet edhe shtëpia kështjellë
me shpatull në dhe e ballë në erë.

Ichte ajo e lidhur me Luftën,
si themelat e gurta lidhen me tokën;
fëmijët, duke kafshuar bukën,
për bukën e maleve mendonin...

4) Nënë Lemja për mëngjesin e luftës

Dita pa çelur mirë
po mbushja ujin e ri;
sy s'pata për hatanë,
fshehur rrinte pa bëza.

Dhe kur ktheva me enët
m'u duk se ecën pemët, —
në oborr, mor bir, shtanga.
E pat. Po, nisi gjëma.

Sot vade gjaku, — thashë
e pişkata për betejë;

Muharrem, Hasan e Shaqë
vetuan menjëherë...

Më s'i pashë, veç krismat
e pushkëve dëgjoja,
gratë thirra dhe sakicat
armë i rrroku dora.

5) S h a q a

Pasha qiell e pasha dhe,
pasha bukën që jep jetë,
kjo shtëpi me ballë në erë
është jona, bre!

Gjakun tonë kërkon të gjithë
gjer në të vetmen pikë!

Lini të vdekurit përdhe,
le të flenë si deshën vetë,
tokë e t'rënëve nënshtrim s'ka,
rrrokni sakicat, gra!

6) Gratë

Sup më sup gratë,
sytë vetëtima,
burrat me armë,
ato me sakica.

Nga ç'balada
vijnë?!
Në ç'balada
hyjnë?!
Bloza e luftërave
ua nxiu shaminë...

7) Sherife moj motër

(*Shaqa për motrën*)

S'janë lulemollë
shtruar përmbi tokë —
piška gjaku në borë
e mbi jetën tonë.

Ti na sjell fishekë,
ikën edhe vjen
dhe mbi lulëkuqe
të duket se shkel.

Sherife, moj motër,
vajzë edhe nuse,
gjaku i vëllezërve
po të ngjet me lule...

Oh, jo! S'është këna
derdhur në pëllëmbë,
duart nëpër plagë
si s'të dridhen vallë?!

Sherife, moj motër,
ti je kaq e vogël
t'i ndërrrosh plagët
sot me lulemollët...

Po lufta e egër,
motër, kur troket
moshat gjithë ngrihen,
dhe fëmijët në djep.

Bëhet gardh çeliku,
qëndresë njerëzore,
ballë çdo armiku
dhe një zemër motre...

8) U k a

Si prilli
ëndrra në sy.

Gjoksi shoshë,
pëllëmbë e majtë
nën kokë.

Kokë në shkëmb,
trupi në lëndinë.
Mbi ballin tënd
një karafil...

Prilli
ç'të jepte më ty?

Shkëmbi çeli
lapidar mermeri,
yll lirie
shkëlqen emri.

9) R u s t e m i

(fëmijë 12 vjeç masakruar nga gjermanët)

Nëno,
lulet gjithë ngrirë
dhe lastar i njomë
s'më jep një bilbil.
Po marr një gëzhojë,
nëno,
ta ve në buzë
e këngën e fundit
me të ta fërshëllej...
A s'është pranverë?
Me tingujt e këngës
tokën do ta shkrij...

10) V e l i u

*Dëshmorit Veli Karakushi i gjetën në gjoks kulaçin,
që ia kishte sjellë motra.*

Në udhëkryq Veliu,
me buzë në tokë
e një fjalë në gojë.

Kulaç i motrës në gji,
diell i vogël
pranë zemrës rri...

Sa diell i globit
gatuam bukën, Veli,
dhe fjalën e pathënë
drit' e çelik e bëmë...

II) Trimat pas betejës

Sa qenë gjallë
lisa në këmbë,
ashtu të vrarë
lisa të rrëzuar,
filizalëshuar...

(12) E p i l o g u e

Mjerë ju që erdhët me shpresë
për të na nënshtruar lehtë!
Mushkat që sollët me hëkur
i ngarkuat me të vdekur
rrugë e pa rrugë, kuturu,
mjerë ju!

Kryqet e thyer në shpinë
çojani zi borgjezisë!
Mjerë ju që erdhët me shpresë,
armiq të pabesë!
Në baltë ua shuam emrat e vdekur,
mjerë ju!

D a s h u r i

1.

Ti je si fara, dashuri, si fara
dhe je aq e mrekullueshme, aq e pushtetshme
edhe në një buzëgaz kalimtar,
edhe në një përshëndetje të vëtme –
ndër të gjitha gjërat më e prekshme,
më e thjeshtë e më e këndshme.
Mendimi im i qartë, vigjilanca je
në syrin tim dhe gishti në këmbëz.
Nëna, e dhembshura, motrat, vëllezërit je
që rriten e rriten në plakjen e bukur të
prindërve.
Je gruaja, fëmijët që më mbushin shtëpinë,
duartokja me shqekun tim je, dashuri.

2.

Ti je si fara, dashuri, si fara,
bindësse si puna. Në syrin madhështor të ditës
e në hapin e pasigurt të fëmijës të ndiej ty.
Je në tokën e përgatiitur për mbjellje,
ky hidrocentral — gjigant mbi bllokadë,
je ky qytet që u bë dritë
me sheshet, udhëzat, shtëpitë
që ti të jesh më e plotë, më e pushtëtshme, dashuri.
Je frymëmarrja e qytetit të ri,
ky pallat je, lëndina me lule e bar,
qielli si sytë e dashur
dhe kjo degë mollë
mbi fytyrën tonë.

3.

Ti je si fara, dashuri, si fara,
e njomë si fëmi, shpërthim i barit të ri,
ëndërr e shumëndërruar-çeliku im i parë,
ja, ky çelik që mbaj në pëllëmbë

e t  shton forc n ty, dashuri.
Kjo udh  fshati me balt ,
shkolla me dritare t  m dha,
f mij t plot sh ndet e men uri,
je lodhja ime dhe lodhja e shokut tim,
q  ti t  jesh m  e bukur, m  e mir , dashuri... —

Nxënësve të mi

Për të ardhur të ju
në shi e furtunë,
në ujin dimëror
futem gjer mbi gjunj.

S'mbeta asnjëherë
në breg si kërcu,
gazi juaj verë
ter rrrobat në trup.

Kur përroi sjell gurë
e fryhet gjer në rrëmbim,
për të ardhur te ju
e kam të vështirë.

Shkronjat nga librat
vijnë varg e varg,
nga dritaret pritja
më rëndon në ballë.

Mandilet e bardha
me cepe qëndisur,
vijnë porsi dora
që të aftron ndihmën.

Në banka të urtë
ulur gjithë ju shoh,
merakun për mua
dhe penën në dorë.

Që të arrij bregun
kaloj mbi shelgjishte,
humbje të mos ketë,
të mos ketë pritje.

Në kohën e dashurisë

Ty të kujtohet, patjetër të kujtohet, s'ka se si
harruar të kesh kaq shpejt.

Në moshën e luleve ishim,
në kohën e dashurisë...

Ishim fqinj,
kur në rrugicën tonë, pranë murit qerpiçngrënë
në lulimin e karafilëve, sa herë karafilë më ke
dhënë.

Të freskët, të pushtë i mbanim në grusht
dhe në shpinën e duarve ngjitej ngjyrë e kuqe.
E mua

zemra jote, më dukej, regëtinte brenda grushtit...
(Më ngrohte zemra jote, sa imja thellë gjoksit.)
Ty të kujtohet, patjetër të kujtohet, s'ka se si

harruar të kesh kaq shpejt dritaren e dhomës, vazon
blu...

(O, qiel i pafund! Yje-karafilët e kuq!)

...Jetojmë kaq vite bashkë. Kemi dhe fëmi.

(Mos harro: në moshën e luleve jemi prap', i dashur!)

Mes luleve shkön e vjen në shkollën e fshatit, —
në lulimin e manushaqeve si s'u kujtove
nën kaçuben e gjelbër të përkuleshe,
lulen erëmirë të këputje pér mua?

Vërtet si s'u kujtove té vish me një manushaqe?!
Mos m'u prek... kjo diçka më shumë është se një
bisedë familjare.

Dhe kjo gjë e vogël ka rëndësi
që ta kuftosh se jemi gjithnjë në kohën e
dashurisë, i dashur.

Jeta e gjyshes si përrallë në fëmijërinë time

— Si? Ti nušk di përralla?!

Ato vite
mendoja se përralla
e ka emrin gjyshe.
Dhe kujtoja fjalët,
rrëfimet e tua,
ngjarjet e hidhura
t'i bëja të bukur...

— Kam treguar të vërteta,
bir, nga jeta ime! —

Nga peshë e të vërtetave të dridhshme
gjyshja e përkulur pak...
Ajo përkulje e lehtë
patjetër është edhe peshë
e fëmijnisë sime...

P i k t o r ë t

*Tulenteve të reja të shkollës «Avni Rustemi»,
Kukës.*

Sa gjëra të bukura lapsi mund të thotë,
kur ato janë diell rrëth nesh,
fillesa juaj s'do ishte kaq e bortë
po të mos ngrihej ky qytet.

Pa prarim kornizash punimet tuaja,
me pineska varur drejt në mur,
po kanë më vlerë se gjithë pikturat
që botën japin rrëmuje.

Ajo rrëmuje ngjyrash gjer në çmenduri
pisket tmerrin dhe vdekjen e vet,
veç rebus me kryqe ky lloj artborgjezi
që veten e quan modern.

E ndiej hijen dhe dritën si ka lodruar,
peshën e karbonit mbi fletë,
mur i zakonshëm shkolle salloni juaj
burrërimin e ardhëm ndez.

Në hapësirën diellore të kohës sonë
qartë rinia e artit flet,
sa gjëra të mençura lapsi të thotë
kur arti është jetë.

V a l l a r j a

Ish si flutur, më beso!
(E ç'mund të ketë flutura
më tepër se ajo?)

Këmba s'e shkelte barin,
as peñaleñ e vetme;
sytë ngjanin me zjarrim
edhe me piña vese.

Fustani porsi flaka
e prushte në mollëza;
çfarë më shumë fjala
se shpirt' i saj thoka?

Dhe m'u bë se lëndina
ndizej zjarre;
prush ëndrre vajzëria
u derdhka në një valle!

Ish si flutur, më beso!
(E çmund të ketë flutura
më tepër se ajo?)

Dita e parë e punës si mësues

Vini dy nga dy, tre nga tre
me pak druajtje në mollëza,
nga vera e bagëtive
në shtatorin e shkollave.

Druajtjen tuaj edhe vetë
brenda kam, po ju s'e shihni —
unë tani po hyj në jetë,
sapo ju në libra hyjnë.

Mësuesi i ABC-së

Brenda dorës sate të voglat duar,
të druajtura, viza hedhin në letër;
nga punët, më e vështira t'u besua —
siguria e Atdheut, e nesërmja.

Se bëhen shkronja vizat e thjeshta,
fjala shqipe më fort do të ndrisë,
ato nesër shndërrrohen në vepra —
madhështi e viteve të Partisë.

Është e rëndësishme ajo dorë,
të voglat ngadalë i fut në jetë,
mençuri e saj kohë më kohë
çel e gjethon, gjethon e çel...

Unaza e Inflandit

«Unë ta lë ty, mbi varrin tënd,
Unazën e Inflandit».

A. Baserman

Mbi dhe të zi Unaza rri,
si trupi yt rri në varr,
ajo për ty ish, Moisi,
nderim për artin e madh.

Më shumë se famë, lavdi —
tërbim e tmerr ai çast,
ish koha kur në Gjermani
mynxyra naziste u shfaq.

Të të nderonte s'kish se si
ajo mynxyrë që u shfaq
antipopuj, antinjeri,
domosdo dhe antiart.

Sipas tyre edhe artin
veç arianët e bënин,¹⁾
po ja, mbi varr të shqiptarit —
Unaza e Inflandit.

Se art i madh ka kaq forcë,
klika, dhunë e terror shkel;
populli kudo në botë
e nderon si emrin e vet.

Mbi dhe të zi Unaza rri,
si trupi yt rri në varr,
plumb i parë mbi nazizmin
i luftëtarit shqiptar...

1) Autoritetet naziște uishtruah presion të hapur mbi Albert Basermanin që Unazën e Inflandit ta trashëgonte aktor me kombësi gjermane.

Muzikanti i lagjes së fshatit

Djalë i vogël me trup të paktë
e me dëshirë të madhe për art,
luan gishtat e vegjël mbi tasta
dhe ëndërron të bëhesh muzikant....

Në muzg, pas punëve të fushës,
gëzimi ynë — i gjerë det,
i bie ti pranë nesh kaq bulkur
si muzikant i madh plot talent.

Vijmë pranë teje, këndojmë bashkë
(këngët e jetës i kemi në shpirë),
djalë i vogël me trup të paktë,
ti kaq shumë na gjëzon të gjithë.

Oh, pse fizarmonika merrka frymë,
s'ka gjë, nuk na shqetëson aspak,
ja, vrapij unë në infermieri
të marr për të pak leokoplast.

Po rrithesh. Do të kesh edhe të re.
Do të bëhenz muzikant i vërtetë
nëse në sallat e koncerteve
këtë fizarmonikë sheh, fushat dhe ne...

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

Fëmijët e parë të qytezës

Të hënën në mesditë,
në orën dymbëdhjetë,
në shtëpinë e lindjes,
në qytezë,
dy fëmijë lindi një bujkesë...

Djalë dhe vajzë, —
trëndafil i kuq
e trëndafil i bardhë.

Jeta me jetë
e rrit dashurinë...

Çadrat ushtarakë

Pa themeli
ngriheni.
Themelet e atdheut
brenda vetes
edhe ju i keni...

Fëmijët e bregut të dritës

Në bregun e dritës erdhët, fëmijë,
me një rrudhëz të lehtë në ballë,
që ngjet kaq shumë me çudinë
sapo nisim t'u themi përrallë.

S'është me arush, njerëz stërmëdhenj
dhe as me ndodhitë e Hirushes
në të kaltërën e thellë.
... Na ish një qytet me emër Kukës.

Dhe përkëdheljen për ju vonojmë pak
mbrëmjeve kur dritësojmë dhomën,
urim i pashprehur ky çast
i njeriut të thjeshtë për kohën.

Udhët ndizen në gonxhen e filamentit,
djersa punëtore pikon dritë,
ju s'e shihni dot qytetin
që ndizet e ndizet për të gjithë.

Me përmassa përralle te ju vijnë
shtëpitë e tij, udhët e pemët;
gjithçka ju shton sot çudinë,
natyrshëm do ta kuptioni nesër..

Lulëzimin e kohës së Partisë
që njeriun vrullshëm ngriti kaq lart:
mbi mohimin e vështirë
guximshëm të bëjë pohimin e madh.

Një natë në barakën e rojes së druve

1.

Të udhëtosh disa orë,
i vetëm
nëpër udhëzat pa gjurmë të malit me borë,
dita të fiket e nata
të bjerë mbi supe qetë-qetë,
në çdo gjë rrëth teje të bjerë,
ftohtësinë e bardhë që grindet të kesh
bashkudhëtare
dhe zhurmën e këmbëve të tua —
sa nevojë ndien për një vatër me zjarr,
për një dorë
që sjell drutë e prera në dhomë!

Eci. Bie. Ngrihem dhe eci me shpresë
se ngrohtësia diku
do t'i shtojë zjarrit të vatrës për mua ca dru...

2.

Pranë barakës së druve arrij
me mendimin e mirë, mikpritës.
Trokas. Mbështetem në derë dhe pres
zërin e ngrohtë të njeriut...
(Sa ëmbël qenka dhe në banesën më të zakonshme
të mbështetesh!)

Dikush ul zërin e radios. Pyet,
me gërvishtje dera hapet.
E shqetësuar fytyrë e njohur shfaqet
me një picërrim të dallojë të posaardhurin.

3.

Ulem në shtratin e tij:
dërrasa të ngritura nga toka një pëllëmbë,
postajë e bardhë përmbi.
— Of! — ia bëri. Dhe heshti me buzë të shtrënguara.

(Ç'mund tē thoshte pikällimi mē tepér se kaq?)

— Çizmet nuk dalin, or mësues,

po do tē bëjmë diçka. —

Nxori briskun e xhepit, çelik e asht:

— Do t'i presim, shpëtojmë këmbët, — tha. —

Mos tē dhimbser, bre!

Sa herë tē miat shokët m'i kanë prerë,
besa edhe vetë! —

Priste çizmet e mia, nxirrte borën e ngirë,
prekte këmbët me butësi njeriu,
i hukaste, u jepte frymë,
ringjallte një pjesë tē jetës ai njeri i mirë...

BINI, MORE DJEM, BINI!

(Kushtrim i vitit 1912)

Qëndresës së malësorëve të Veriut
kundër synimeve shoviniste serbe.

WAGNER'S MUSICAL DRAMA

BY ERNST REINHOLD

TRANSLATED BY
EDWARD STURGEON

I) Thyerja e malësorëve në Qafën e Dules

— Para një humbjeje të përkohshme gjithkush, —
tha, — mund të ndodhet.

Burrë është ai që sheh fitoret. —

Dhe heshti prijësi tirqebardhë.

Nga Qaf' e Dules ktheu shpinën.
zemërvrarë.

Kjo do të thoshte se po e linin
atë qafë humbjeje si një varr...

Toka nxinte nën këmbët e tyre,
qielli, si toka, mbi krye.
Tirqit e bardhë me pllanga të kuqe —
kur vallë u kthyen me humbje?

Kapërcyen shkëmbinj e kroje,
të freskohen askund s'u ndalën,
thua prush i luftës shuhej.

As sytë s'i ngrinin
majat e maleve të shihnin,
thua majat u rrafshuan...

Pranë shoqi-shoqit ecnin,
as fytyrë, as zë s'i jepnin, —
kaq shumë u dhimbte
për qka linin...

Një udhë rrıhnin helmi me gëzimin,
në thembrat e thyerjes
fitorja vinte gishtat.

... Prapa tyre marshonte armiku
me tupana e bori (!)
(Për dheun tonë po lodroka?!
(Për dheun tonë po këndoka?!)
Ooo, tokë e zezë,
qiell i zi!

2) Kthimi i malësorëve

Ke gëzim se shtove shtëpinë me një njeri?!
Praje¹⁾, more, gëzimin tënd të vogël!
Kushtrimin s'të lë ta dëgjosh.
Praje, more! Dil, dil të shohësh:
burrat prej Qafës së Dules erdhën
pa gaz në buzë,
terë prej udhe e humbje,
me malet e thyerjes mbi supe.
Sekush ngjan me tri plagë
nën sqetull...
Dhe në ballë
për atdhe secili ka të shkruar vdekjen.
Ooo, çfarë do të bëhet këtu!

1) Pushoje

Sa zor e ka të kallëzojë
kush do të mbetet!
Shtëpitë i harruan,
fëmijët s'i përkëdhelin.
Si shqipe qepur shkëmbinjve
një Fushë Kosovë të re
a një Vajkal (Vëzë i rreptë) të
të ribëjnë kërkojnë...
Praje, more, gëzimin tënd të vogël!

3} Kushtrimi

*Vloj kushtrimi — kush asht burrë,
rrokni armë e rrokni pushkë...*

*A po vjen, burrë, për me vdekë,
vish kollanin me njëqind fishekë!*

Kushtrim, për besë, djale më djale,
derë më derë e bjeshkë më bjeshkë.

Kushtrim

dy nga dy
e tre nga tre
për atdhe!

Lëshojnë zë:

«A po vjen burrë për me vdekë,
vish kollanin me njëqind fishekë!»

E po ia përcjell burri burrit
e dheu dheut,
shkëmbi shkëmbit e djepi djepit,
i gjalli të gjallit
e i vdekuri të vdekurit,
Kulla e Lumës Qafës së Kolesjanit
e Qafë e Kolesjanit Luginës së Goskës,
thjesht, o sa thjesht
gojë më gojë kulumohen në Qafëqytezë.

Thirrja e lashtë e Skënderbeut
në fundvjeshtën e vitit '12
mbi ngjarje gjaku fluturon...
A po vjen burrë për me vdekë,
vish kollanin me njëqind fishekë!

4) Kulla e Lumës, 1912

*Gjithë Evropa duhet ta dijë,
lufton Luma për Shqipni;
Ky kral Pjetri po ban medet:
«Luma e kuqe m'faroi krejt!»*

Mbi mua ju po shkelni rëndë-rëndë,
si asnjeherë kush tjetër këmbën s'e ka vënë.
Brenda meje ndiej si nxihet e don të çahet guri,
të bëhet copë-copë.

Brinjët kërcasin, lakohen si thupra
nga mijëra këmbe të huaja.
Kjo peshë e hatashme gjithë bujë,
tërbim robëruesish gjer në çmenduri,

mbi vdekjen time të marshonte më mirë, së gjalli qenka shumë yështirë.

I pashë djemtë nga Qafë e Dules të vinin
helm e vrerë e pa gojë,
po thashë ditkan gjë përfundin e botës
(më lehtë se humbjen këtë besova).
Ta dija kështu do qepja qefinin,
në ujërat e mi të vetvarroshë.

Tash për gjithçka është vonë...

Dhe mendoj se patjetër një ditë, një orë
poshtë meje do kaloni pa frymë
copëtuar nga valet me borë,
nën këmbët e mia të shtrirë...

Vetëm kështu duroj të parën shtypje që kur më ngritën bijtë të lidh dy brigje, (brigjet që ju doni të m'i ndani).

dhe s'nxjerr as zë, as klithmë;
veç pikëllimin gjëmë shkulma-shkulma nis pér udhë,
këmbëve të maleve ta pérplas kushtrim
që ju të mbyteni në tmerrin tim.
Me kushtrimin tonë t'ju bëjmë copë-copë
e nga gjaku, nën mua ç'rrjedh, ngjyrë të ndörrojë...

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

—
—

5) K o l e s j a n i

*Kolesjani shtatëdhjetë shpi
s'duron zgjedhë, |
s'duron robni...*

Kolesjan — fytyra ime,
ballë në shtatë gjëmime.

Ranë shpata, u copëtuan,
ranë gjyle e u shikrinë,
ranë gjuhë, u varruan,
ranë ushtri e u nxinë...
... E ti prap' aty, i gurtë,
zemër dhe trëndafil.

Kolesjan — qëndresa ime,
zëri në shtatë gjëmime...

6) Njeriu me kosë

*Gjithë ditën luftoi me kosë
në fushën e Shtiqnit...*

Fushë e Shtiqnit, moj e zezë,
çfarë të korr e çfarë të mbledh!

Fort piskata mu në derë,
u dridh tokë e u dridh qiel.

Lypa armë e kund nuk gjeta,
gozhdët¹⁾ qenë gjithë të shkreta...

Rroka kosën e kosita
copa fjalësh të armiqve.

1) Gozhdët e armëve

Kosa hante ëndrra kralësh
emrashuar në gjak fjalësh.

Fushë e Shtiqnit, moj e kuqe,
tokë jete dhe shesh lufte.

7) Djemtë e Lumës

*Djemtë e Lumës nuk kishin dert,
kah nji pushkë e bajshin vjet për vjet,
luftë me krajla e luftë me mbret...*

Një natë qe. Vetëm një natë e gjatë,
pa fund,
me terrin e vitit dyimbëdhjetë.
Shkelte mbi gurët e kuq,
dhe shiu (oh, ç'shi!) lante e lante
pamje të lemerishme,
që e nesërmja vetëm shqiptare
të lindte
në tokën e shqipeve.

(Sa e pritëm atë qast shkëmbinje
qepur,

sa e pritëm!

Trupi për guri,

faqja për pushke.

Dhe ashtu do të rrnim

në pritje,,

gjersa vera dimrin të shkrinte

e toka të lulonte

nëpër trupin tonë...)

U derdhën nga brinjat e Kolesjanit
malësorët

tirqebardhë. Lule të bardha nëpër natë.

Mbi ushtri ranë

dhe s'e dinin

mbi c'pellgje shkelnin,

mbi të shiut apo të gjakut..

... Ish koha

kur terr e tmerr tërbohej në Qafëqytezë,
borive të kushtimit u binte Goska

e Kullëluma

pikëllimin-gjémë niste për udhë
shkulma-shkulma...

8) Kushdo që vjen të prishë gjuhë e komb

Bukëshkelës, po prin? Një xhuxh sheh?¹⁾
Edhe zotin do ta kishim gri,
t'i printe kralit me ushtri.

Besëprerë, një pusht pa atdhe –
vjen të shesë fytyrën tonë,
vjen të prishë gjuhë e komb.

Djem, shpirtin t'ia marrim me dorë!

1) Në Qafën e Kolesjanit ushtrisë armike i printe
shehu vendas

9) Bini, more djem, bini

*Islam Spahia¹⁾ në gjysmë të motit,
hiç s'po i tutet gjyles topit.*

Prej zogjve të hekurt tutë mos kini,
bini, more djem, bini!

Po dridhen topçinjtë në Qafë,
zot edhe kral po shajnë.
Qafë e Dules, moj e zezë,
pa afrohu e shih vetë!

Prej zogjve të hekurt tutë mos kini,
bini, more djem, bini!

1) Prijës populor

10) Në Qafëqytezë

Ç'terr e tmerr tërbohet rreth e rrreth!
Qafëvdekje, moj Qafëqytezë!
Erërat shpërthyen ku qenë e ku s'qenë,
me tërbim vrapojnë, pluhur e gjethe ngrenë.

Vjeshta, erërat e malësorët
(hasianët me pak gaz të idhët në buzë)
lëshuan furtunat e qiellit dhe tokës.
Me rropamë rrrokullisen lisa e gurë;
buaj, qerre, ushtarë përlajnjë.
Vullkani popull nis lavën e zjarftë.
Ç'terr e tmerr tërbon rreth e rrreth,
qafëvdekje, moj Qafëqytezë!
Kështjellë e lashtë, kështjellë e re!

II) Smajl Arifi¹⁾

*Njëzet qafira i ka faru,
njëzet qafira e nji kumandar.*

Smajl Arifi pret e grin,
e rralloi krejt ushtrinë.

Smajl Arifi vetëtimë,
e kuqloj krejt ushtrinë.

Lis e dhe, furtunë e mal
qankan bashkë në një Smajl!

1) Luftëtar nga Vau Spasi

12) Goskë, 1912

*Sulm po bajnë trimat malësorë,
i kanë kapë topat me dorë.*

Miq të erërave e dimrit,
zotër të tokës e qiellit,
shpateve thikë të Goskës
malësorët nisen
topat t'i zënë me dorë.
Grykat ulërijnë,
godasin mbi krye të armikut,
në katrahurë udhë ikjeje
kërkojnë
(udhët janë zënë),
thërrasin.
Përplasen për shoku-shokun,
armët hedhin,

shemben përdhe,
shkulin leshrat,
oficerët-spaletat.
I luten qiellit,
qielli ka rënë.
Si traktate të grisura,
tupanat skelet të armikut!
shkelen këtu-atje.
(Merreni lëkurën e kralit,
vishni tupanat!...)

Malësorët me kokën te dielli
ngjiten shpateve të Goskës.

13) Topi i Prengë Kovaçit

Fatin e keq të shurdhimit pati
Prengë Kovaçi,
që pritën braktisi kaq lehtë?
A pér të më luftë s'ka
e një trung të rrëzuar po gdhend
qetë-qetë?

Nga mëngjes i hershëm në darkë
e nga darka gjer në mëngjesin tjetër
pér duart e tij picakja sëpatë
më e rëndësishme se Leva e Arkimedit...
Fatin e mirë të krijimit pati
mjeshtri Prengë Kovaçi;
atje në Lajthizë, në borë,
këngën nisi topi...

14) Lajmësit e fitores

Qysh të merrej vesh Kullëluma me Goskën?
Udhët qenë zënë,
telat nuk i donin¹⁾...

Kullëluma nisi ujin e kuq lajmës,
Goska një furtunë
me gjethe të përgjakur,
Qafëqyteza një këmishë luftëtari
e ngriti flamur...

Dhe lajmëruan fitoren.

1) Malësorët i shkatërronin linjat telefonike, si mjet i shpejtë komunikimi i armikut.

PASQYRA E LËNDËS

Urat e Kukësit	3
Mesnata në qytezën minatore	9
Likeni i kuq	5
Qyteti i dritës	6
Largimi i brrutasve për në Krumë	7
Dritë pune	9
Fusha pas mbjelljes	11
Pragmbrëmja e së shtunës në fshatin e ri	12
Natë shirjesh	14
Brezat	16
Opingat e Hasit	17
Punëtorët e fushës	19
Fytyra e shokëve	20
Vjen një moshië	21
Vrasja e korrierit partizan	22
Një nënë këndon dëshmorët	24
Mos kujtoni se kemi harruar!	25

LULET E PRILLIT

Prologu	31
Lieber gott!	32
Shtëpia	34

Nënë Lemja pér mëngjesin e luftës	35
Shaqa	37
Gratë	38
Sherife, moj motër	39
Uka	41
Rustemi	43
Veliu	44
Trimat pas betejës	45
Epiologu	46
Dashuri	47
Nxënësve të mi	49
Në kohën e dashurisë	51
Jeta e gjyshes si përrallë në fëmijërinë time	54
Piktorët	56
Valltarja	58
Dita e parë e punës si mësues	60
Mësuesi i abcsë	61
Unaza e Inflandit	62
Muzikanti i lagjes së fshatit	64
Fëmijët e parë të qytezës	66
Çadrat ushtarake	67
Fëmijët e bregut të dritës	68
Një natë në barakën e rojës së druve	70

BINI, MORE DJEM, BINI

Thyerja e malësorëve në Qafën e Dules	75
Kthimi i malësorëve	77
Kushtrimi	79
Kulla e Lumës, 1912	81
Kolesjani	84
Njeriu me kosë	85
Djemtë e Lumës	87
Kushdo që vjen të prishë gjuhë e komb	89
Bini, more djem, bini	90
Në qafëqytezë	91
Smajl Arifi	92
Goskë, 1912	93
Topi i Prengë Kovaçit	95
Lajmësit e fitores	96

Spahiu, A.

Vjen një moshë. Poezi. [Red.: R. Vozga], T., «Naim Frashëri», 1982.

100 f.

(B.m.) dhe

(B. v.) :891 983-1

S 81

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1982